KOSOVARJA

Ballina: Mirvete Rashiti
Foto: Admir Sahiti

A është edhe populli si liderët tanë

Ku mbetën shqiptarët e Ohrit

Ç'thotë njeriu me 17 plagë në trup

Gjykatës, të lutem, më qo në burg

Këngëtarët tanë që merren më politikë

Pse nxënësit me zor shkojnë në shkollë

Fifi i shkruan letër vetvetes

MIRVETE RASHITI, gruaja me krahë dhe forcë të engjëllit

HELFER GENEVE
ALAYAH LUXURY STYLE
SHERWOOD
BREZOVICA
CIMA
UB UNION BUSINESS ALBANISCH & DEUTSCH
DINO CERAMICHE
Shkabaj
MOLLA
Shkenca Dyhen
anaderm
DENTFIX
allure

DINO
COMPANY

www.dino-company.com

Green Park
RESIDENCE

www.greenpark-ks.com

★★★★★
BREZOVICA
HOTEL & SPA

www.brezovicahotel.com

DINO BETON
DINO NDËRTIMI
DINO QERAMIKA

A është edhe populli si liderët?

Është vështirë të lindet njeriu që e kishte kërkuar Migjeni në poezitë e veta, në krijimtarinë e vet, duke arsyetuar ndryshimin "Të lindet një njeri!".

Po bëhet një shekull që po kërkohet ai njeri. A do të ishte ai një Skënderbe, apo një tjetër njeri, pak ka rëndësi, por rëndësia qëndron në faktin se ai duhet lindur, e që t'i orientojë shqiptarët në rrugën e duhur kombëtare.
Por, deri më tani nuk është lindur!
Një i tillë, përafërsisht, siç e lypte Migjeni, ishte Ibrahim Rugova, pas të cilit, gjatë një dekade të plotë, u rreshtua populli i Kosovës dhe u betua në të...

PSE FQINJI IM NUK PAJTOHET SE ÇDO QEVERI KA PASUR DËSHTIME?

Ditë më parë rastisa të pija një gotë raki me një fqinj timin, e që ka punuar në një post komunal. Si njeri në pension, ai tash ka kohë të lirë për debate spontane... Ma mori për të madhe kur i thashë se buxhetin e Kosovës e kanë keqpërdorur qeveritë e mëhershme, kryesisht me ndërtimin e rrugëve.
Nuk u pajtua se buxheti është keqpërdorur. Nuk u pajtua se Kosovës bisedimet në Bruksel i kanë sjellë dështime, ndërsa Serbisë avancim për në Evropë. Nuk u pajtua se qeveritë e mëhershme e kanë sjellë Kosovën buzë falimentimit ekonomik...
Njerëzit, e që nuk janë absolutisht në ngjarje me rrethanat politiko-ekonomike në Kosovë, akoma vlerësojnë me ato kute që kishin matur dikur në komunizëm, e që copa e prerë e basmës duhej t'u bie tamam të gjithëve që kanë nevojë për veshje.

POLITIKANËT TANË NUK E SHIKOJNË INTERESIN E QYTETARIT, POR TË PARTISË QË I TAKON!

I ngarkuar me zhgënjim, i thashë vetes:
Kush do e lindë atë njeri në këtë masë?! Me siguri, tash jo se jo!
Ndoshta brezat e ardhshëm do e lindin njeriun që e ka kërkuar Migjeni, që politikani të punojë për popull, e jo për vete dhe parinë e vet...
Njeriu migjenian do i trajtonte njëjtë të gjithë shqiptarët, pavarësisht orientimit të tyre politik.
Sepse, tash për tash, politikanët tanë nuk e shikojnë interesin e qytetarit, por të partisë së cilës i takon!

S. K.

Mirvete Rashiti është nga ato femra, që natyra i ka pajisur me shumë virtyte, talente dhe forcë të pashterur.
E njohin, sepse ajo është këshilltare personale, motivuese, medituese, terapiste masazhi dhe estetiste.
Ka ndjeshmëri të lartë, është e sinqertë, direkte, temperamente dhe ka dashuri e energji hyjnore, përmes së cilës u ndihmon të tjerëve.
Engjëll në pamje e shpirt, Mirvetja po bëhet dita-ditës dora për të cilën mbahen shumë gra që kanë nevojë për motiv, energji, këshilla dhe dikë që t'i dëgjojë e ndihmojë për të arritur sukses, balancë dhe stabilitet me veten, rrethin dhe gjithçka tjetër.
Për ata që nuk e njohin Mirveten, mund ta kontaktojnë në Instagram në mirvetespabeauty_coaching, adresë e duhur për ato që kërkojnë këshilltare psikike e shpirtërore, dikë që i ndihmon në mënyrën më të mirë për të luftuar problemet: përballja me frikën, fobitë, traumat e fëmijërisë, pasigurinë dhe mungesën e vetëbesimit.
Për herë të parë, Mirvete Rashiti flet haptazi për të gjitha në "Kosovare"...

Mirvete Rashiti, gruaja me krahë dhe forcë të engjëllit

Kush është Mirvete Rashiti?
- Jam rritur në Kumanovë, që njihet si vend i heronjve shqiptarë dhe njerëzve të mençur. Kisha një jetë të bukur në atë vend, ku mësova zanatin e frizeres dhe kultivova atë që buron nga shpirti im, poezinë dhe recitimin. Isha drejtuese e emisioneve të ndryshme në një nga radiot më të dëgjuara.
Tani studioj për masazh shëndetësor ose fizioterapi. Shumë më njohin si energjimëshiruese, këshilltare, motivuese, medituese dhe mësuese spirituale. Gjithashtu, merrem me estetikë, me tretmanë të fytyrës dhe extension të flokëve të markës "Ajkune Professional".

Pra, je femër multidimensionale. Si arrin t'i bësh gjithë këto gjëra, njëkohësisht?
- Bie të fle në orën 12 të natës, kurse zgjohem në orën 6 të mëngjesit. Për mua dita do të duhej të ishte 48 orë. Kam qenë gjithmonë shumë dimensionale dhe kjo

është ajo që më diferencon, sepse mund të bëj disa gjëra njëkohësisht.

Me çka merresh më me pasion?
- Të gjitha punët i bëj me pasion dhe dashuri të rrallë. Gëzohem jashtë mase kur klientëve arrij t'u ndihmoj që t'i kthjellojnë mendimet, të jenë të qetë shpirtërisht. Kur i shoh të lumtur e me shpresë, përmbushëm.

Njiheni për energji pozitive, jeni motivuese dhe dimë që u ke ndihmuar edhe shumë njerëzve të famshëm të gjejnë forcën, motivin. Si është të punosh me ata njerëz?
- Para pesë vjetësh nisa të interesohesha më tepër për spiritualitetin, shkaku i ndjeshmërisë sime të lartë dhe zbulova që kam një energji mëshiruese.
Dhe, kështu, nisa ta vë atë në praktikë, fillimisht me shumë dyshime dhe frikë. Kjo energji pozitive apo hyjnore, rrjedh nga universi ose kozmosi direkt te unë, e unë e përcjellë te të tjerët.
Është diçka engjëllore, e fuqishme. Kjo është energji e pastër, pa manipulime ose rituale. Unë e kombinoj hipnozën dhe meditimin, kujtimet dhe përjetimet negative dhe i transformoj në pozitivistet. Por, kjo nuk ndodh vetëm me një seancë.
Është e vërtetë që punoj me klientë të nacionaliteteve të ndryshme, me njerëz të njohur e me karrierë, të huaj e shqiptarë, të cilët kanë probleme mentale dhe shpirtërore, shkaku i përgjegjësive të mëdha që kanë në jetën e tyre dhe për këtë kanë bllokadë mentale e shpirtërore, të cilat mund t'i pengojnë në realizimin e mëtejshëm.

A parashikon të ardhmen e njerëzve, të botës dhe rrjedhën e gjërave?
- Unë nuk e shikoj të ardhmen, por marr sinjale për gjëra të rëndësishme që do të ndodhin te një individ apo më gjerë.
Në fillim frikësohesha nga gjërat që i dija, trishtohesha nga ngjarjet e këqija që më vizualizoheshin në mendje dhe bëheshin realitet...

Ke lindur me këto dhunti, apo i së fituar gjatë jetës?
- Kam lindur me këtë dhunti, që dikur nuk doja ta pranoja, por njerëzit më kërkonin ndihmë. Dikur e fshihja këtë dhunti dhe nuk e dija a duhej të krenohesha apo të turpërohesha që e kam.
Dhuntitë e tilla janë hyjnore, nuk mund të mësohen, edhe pse shumë sharlatanë mashtrojnë e manipulojnë për përfitime të veta, duke gënjyer se kanë diçka më shumë.

Cilat problematika i trajton?
- Ato që nuk janë sëmundje të pashërueshme, si, për shembull, bllokadat psikike e shpirtërore, të gjitha pengesat për të qenë njeri i shëndetshëm dhe stabil, pastaj frikën, fobitë, ankthin, transformimin e energjisë negative në pozitive etj. Jam mësuese spirituale dhe shpesh klientët më thërrasin engjëll.

Ju pëlqen edhe estetika. Na fol më konkretisht çka?
- Për një femër është tejet e rëndësishme mirëmbajtja e vetes, lëkurës, flokëve. Nuk duhet të jemi perfekt, por të kënaqura me veten. Unë jam edhe estetiste, profesion që e bëj me pasion.
Këtu, në Zvicër, kam bërë disa kurse për pastrimin e fytyrës, për tretmanë të ndryshëm, zgjatjen e flokëve dhe, së fundi, po punoj me klientet e mija me flokët e "Ajkune Professional", që janë tejet kualitativë.

Dukeni grua e fortë. Ku e gjen forcën, motivin?
- Dua të jem shembull i mirë për vajzat e mija, për njerëzit, për botën. Dua të përcjellë vullnet e vetëbesim.

A jeni përballur me sfida në jetë?
- Sfidat na bëjnë më të fortë. Shpesh mund të rrëzohemi, por madhështia është te mënyra se si ngrihemi, zgjohemi dhe triumfojmë.
Në udhëkryqet e jetës ka të papritura, natyrisht...

Cila është jeta juaj private?
- Jam martuar e re, në moshën 20 vjeçe. Erdha në mërgim dhe këtu jeta ishte ndryshe, kishte sfidat e veta si në jetën private dhe në atë profesionale. Gëzimi im më i madh janë dy vajzat e mija, që janë mrekulli të jetës sime, për të cilat sakrifikohem dhe bëj çdo gjë që ato të jenë mirë, të lumtura dhe të mos u mungoj gjë.
Kam arritur t'i edukoj me shumë dashuri, urtësi dhe respekt.

Ku mund t'u gjejnë të interesuarit?
- Ndodhen në qytetin Chur të Zvicrës. Në mënyrë fizike në zyrën time janë të mirëseardhura vetëm zonjat për terapitë, tretmanët dhe seancat spirituale. Ndërkaq, këshillimi me personat e gjinisë së kundërt realizohet vetëm përmes telefonit dhe kanë efektshmëri të njëjtë. Kam veb-faqen time dhe të gjitha të dhënat në Instagram.

Mesazhi yt?
- Mëso, puno dhe adhuro jetën tënde! Ndërto diçka prej saj, qëndro pozitiv për veten dhe të tjerët, sepse, në fund, vetëm sinqeriteti, drejtësia dhe një shpirt hyjnor mund të jenë aty ku dëshirojnë!

Nderim Neziri

Pamje e Ohrit e vitit 1940

Dikur ishin 80 për qind

Ku mbetën shqiptarët e Ohrit?

Dikur Ohri ishte qytet i rëndësishëm për shqiptarët, si për nga prezenca, ashtu edhe për ndikimin e madh të banorëve të tij për kauzën shqiptare, aq sa patriotët shqiptarë e konsideronin kryeqytet i shqiptarisë...

Në momente të caktuara të Rilindjes Kombëtare në shekullin XIX, Ohri, nga patriotët shqiptarë, propagandohej si kryeqytet i Shqipërisë së pavarur nga perandoria osmane.

Mbi 80 për qind e banorëve të Ohrit kanë qenë shqiptarë. Por, sot, pas njëqind vjetësh, gjërat kanë ndryshuar shumë. Tashmë prezenca shqiptare këtu është simbolike dhe e papërfillshme dhe, pa dyshim, shpërnguljet në drejtim të Turqisë dhe migrimet më të vonshme drejt Evropës dhe Amerikës kanë bërë të veten në boshatisjen e këtij qyteti nga shqiptarët.

Nga 80 për qind e banorëve shqiptarë, kanë mbetur vetëm 6 për qind!

Ohri, sipas të dhënave, ka mbi 50 mijë banorë, nga të cilët vetëm 6 për qind janë shqiptarë, apo 2800 sish, thotë gazetari Marin Mema në "Gjurmë shqiptare". Në qytet ka mbetur vetëm një lagje, në Pazarin e Vjetër, ku ende flitet shqip.

Maqedonasit i përkasin fesë ortodokse, shqiptarët dhe turqit janë të fesë myslimane. Shtrohet pyetja: Ku mbetën shqiptarët ortodoksë, e që dikur përbënin shumicën e popullsisë së qytetit?

Dihet se treva e Ohrit dhe ajo e Shën Naumit kanë qenë të populluara, kryesisht, me shqiptarë ortodoksë. Edit Durham ka shënuar që qyteti i Ohrit, në vitin 1904, "ishte një qytet mysliman", d.m.th., qytet shqiptar.

Por, tash, kur një pjesë e madhe e shqiptarëve ortodoksë e ndiejnë vetën maqedonas dhe një pjesë e madhe e shqiptarëve myslimanë veten e quajnë turq, numri i atyre që, vërtet, ende e ruajnë veten shqiptarë është mjaft simbolik, sa pakkënd dëgjon të flasë shqip!

Le të marrim një shembull konkret, për të ilustruar mendimin e mësipërm: Në qytetin e Ohrit ka një shkollë fillore ku mësohet në gjuhën shqipe "Vëllazërim Bashkimi", ku numri i nxënësve shqiptarë është reduktuar në masë të madhe.

Para disa vjetësh ekzistonin katër klasë të para, me nga tridhjetë nxënës shqiptarë, ndërsa sot mësimin e ndjekin vetëm dy klasë me nga pesëmbëdhjetë nxënës!

KU TA GJEJ NJË QETËSI?

Fillimdimër. Erë me shi të ftohtë. S'mund as të fle. Më kot përpëlitem në krevat herë djathtas e herë majtas...
Në këto momente mundohem të gjej diçka me çka do i kaloj këto çaste të neveritshme, qoftë me ndonjë emision televiziv...
Por, kot. Ngrihem nga shtrati...
Mbi tavolinë të punës: libra, materiale të ndryshme, fletë me shënime gjithfarë, të pa seleksionuara... Marrë ca prej tyre, të cilat i kam shënuar vetëm si skica orientuese për t'i zgjeruar pastaj, herë do kurdo, në një kohë...
I rishkruaj ashtu siç i paskam shkruar dikur...

*

Njerëzit e pasur nuk kanë kohë më shumë sesa njerëzit e varfër. E, pse?
Të pasurit kanë frikë se do të bëhen të varfër. Të varfrit kanë frikë se nuk do të kenë sukses për të gjallëruar. Jetojnë me shpresën: Zoti e bën mirë!

*

Në një ndejë ode, para shumë vitesh, në fshatin Turiçicë, një plak, gjatë fjalës së tij, pat thënë: "Katër gjëra është mirë t'i shfrytëzosh gjatë jetës:
Rininë para pleqërisë,
Pasurinë para varfërisë,
Shëndetin para sëmundjes,
Jetën para vdekjes...

*

Heshtja është më e rëndë se fjala. Si të qëndrohet, si të durohet? Thonë: Heshtja është ar. "Jo", thotë njëri me përvojë të gjatë të jetës.
Heshtja është zjarr që djeg pa e ndier, që veten si pasuri e shikon të derdhur shpuzërim. Apo ti s'do të flasësh se të janë mërzitur çirrjet që s'ti dëgjon kush, ke mbetur duarthatë, të kanë shqitur mirë.
Por, siç do të thoshte poeti i mjerimit, Migjeni: "Më s'besoj në fjalët e kësaj bote!".

*

S'ka njeri (ai që ka ndjenjë, shpirt e zemër) që nuk i zgjohet brendësia dhe t'i thotë shpirtit: "Ç'ke sonte që nuk më lë të qetë, je dalldisur o shpirti im?!".
Sigurisht, edhe poeti i madh, Khajami, ka qenë në të tillë gjendje shpirtërore, kur shkroi:
Natën kur flija, më tha shpirti: Pi!
Në gjumë dhe në varr s'ka lumëri,
Ngrehu! Sa rron zbraz kupa e puth çupa
Ke shekuj që të flesh në qetësi!

*

Eh, shpirti...
Ku qetësia?

Gani Dili

KOSOVARJA
magazinë e pavarur
për familje
www.kosovarja.al

Pronar dhe botues:
Gani DILI

Redaktor përgjegjës:
Isa ILAZI

Menaxher:
Driton DILI

Redaksia:
Safet Krivaça (reporter i lirë)
Nderim Neziri (redaktor)
Besiana Dili
Drenushë Haredinaj
Rilinda Krasniqi
Ardita Dili

Dizajni:
Labinot Bërbatovci

Adresa e redaksisë:
Fahu postal 18, 10000 Prishtinë
Tel: 038 51 75 75
Email: info@kosovarja-ks.com

Marketing:
Tel: +383 44 143 448;
Email: marketing@kosovarja-ks.com

Në Martiraj të Vushtrrisë

Ç'thotë njeriu me 17 plagë në trup?

Pasi shkrehën rafale në shtëpinë e Selatin Garxhaliut, çetnikët u futën brenda dhe vranë të gjithë anëtarët e familjes që u gjetën aty. Vranë edhe fëmijën shtatë vjeç dhe plakën 90 vjeçe! Tre të tjerët i ekzekutuan pak më larg shtëpisë, te lumi...

Me shtatëmbëdhjetë plagë në trup, z. Bel Gerxhaliu, burrë 52 vjeç në kohën kur e zhvilluam këtë bisedë në vitin 2002, nga fshati Martiraj i Ultë (ish- Studime) e Vushtrrisë, e kishte tepër të vështirë të kthehej për të satën herë në të kaluarën e krimit çetnik mbi familjen dhe ta shpjegojë ngjarjen e rëndë për mediumet, kronologjikisht ashtu siç kishte ndodhur...

Bel Gërxhaliu, trupin e të cilit e kanë shpuar tre plumba dhe shumë copa granatash, e që herë pas herë i dalin nga trupi, është pjesëtar i familjes së dëshmitarit që ka dëshmuar në Hagë, Shukriut, në pjesën e dytë të muajit shtator të vitit 2002. Shukriu ishte dëshmitar kundër Millosheviqit në Hagë, për të dëshmuar rrethanat e vrasjes së gjithë familjes së Selatin Gërxhaliut dhe qindra krimeve që shkaktuan serbët në fshatrat Martiraj e Poshtme dhe e Epërme, më 2 maj 1999 dhe 31 maj të atij viti. Në këto dy fshatra janë vrarë 148 shqiptarë dhe trupat e tyre pushojnë në varrezat e fshatit Martiraj

të Epërm.
"Kanë dashur të na vrasin të gjithëve", thonë në Martiraj, duke treguar tmerrin që shkaktuan serbët dhe romët në Kooperativën Bujqësore të Vushtrrisë dhe në burgun e Smrekovnicës, ndarjen e burrave nga gratë dhe mënyrat e rënda të krimit mbi civilët e pafajshëm.

Ç'THOTË SEBAHATE GËRXHALIU, DËSHMITARE E NGJARJES SË VRASJEVE?

I tronditur nga ngjarjet dhe me plagë në trup, z. Bel Gërxhaliu, i lëshon radhën bashkëshortes, Sebahate Gërxhaliut, 46 vjeçe, e cila i kujton ngjarjet me përpikëri, ndërsa Beli tregon se duhet të del në orën 13, të datës 5 maj 2002, ta merrte Shukriun që kthehej nga Haga, ku kishte dëshmuar kundër Millosheviqit.
"Ishte e hënë, 31 maj 1999, ora 7.20 e mëngjesit, kur oborri ynë është mbushur me njerëz që po e lëshonin lagjen, duke ikur nga paramilitarët serbë që po futeshin në lagje, për të vrarë civilë, shqiptarë", deklaron znj. Sebahate Gërxhaliu, duke shpjeguar rrethanat e vrasjes së Selatin Gërxhaliut, axhë i bashkëshortit.
"Kam qenë duke i mjelë lopët. Kam dëgjuar shumë rafale. Serbët kishin hyrë në shtëpinë e Selatinit, por paraprakisht shtëpinë e kishin qëlluar me rafale, që të pamundësohet dalja e familjes jashtë.
Kanë hyrë brenda dhe i kanë zënë të gjithë anëtarët e familjes që kanë qenë aty.
Kur hyra në oborr të Selatinit, thirra, por askush nuk më ktheu përgjigje. Kisha një parandjenjë shumë të keqe. Askush nuk lëvizte. Nuk kishte zhurmë...
Dhe, para se të futesha brenda, pash nga larg tek vinte drejt meje Haxhi Salihu, me tri kufoma të ngarkuara në qerre. Kur arrit në oborr, zbriti nga qerrja dhe hyri në shtëpinë e Selatinit, që të shihte çka kishte ndodhur...
Me të hapur derën e kuzhinës, pa të vrarë nënën e Selatinit, Salihen (80 vjeçe), gruan e Selatinit, Fexhrien 38 vjeçe, kunatën e Selatinit, Sofinë me djalin 7 vjeç, Seferin dhe fëmijët e Selatinit: Muharremin (14), Mexhidin (11), Abdurrahmanin (10), Nyberanë (7) dhe Sabahudinin (6).
Por, katër ditë pas hyrjes së forcave të NATO-s, u vra edhe djalë tjetër i Selatinit, Shahini (14), i cili po kthehej në shtëpi, pas qëndrimit në Vushtrri. E ka vrarë një polic që ka shërbyer tri vjet në fshatin tonë. Ka qenë vrasje shumë e rëndë, sepse u shua e tërë familja e Selatinit", tregon dëshmitarja.

NUK LEJOHEJ VARROSJA E TË VRARËVE!

Duke shpjeguar procesin e ngjarjeve pas vrasjeve tronditëse në familjen Gërxhaliu, znj. Sebahate, e ndihmuar nga bashkëshorti, thotë: "Kishte shumë të vrarë dhe nuk kishte mundësi të varroseshin të gjithë. Lëvizjet tona dukeshin si në shuplakë dore.
Në ato rrethana, burrat i morën tri kufomat që ndodheshin në qerre, i çuan te varrezat dhe i lanë aty, ndërsa kufomat që ishin brenda shtëpisë Selatinit, në kuzhinë, burrat morën vendim të mos preken, por të lihen aty deri në ndonjë moment të volitshëm, që mund të vinte me ndryshimet e situatës.

SI POLEMIZUAN SERBËT PRANË KUFOMAVE?

Sipas Sebahates, që e vazhdon rrëfimin me një tjetër zhvillim, serbët krijuan mes vetes mosmarrëveshje...
"Pasi është njoftuar policia serbe në Vushtrri, në vendin e ngjarjes kanë ardhur forcat serbe, policia, ushtria, mjekë dhe të tjerë...
Filluan të fotografonin, të bënin procedurë, t'i mblidhnin gëzhojat e fishekëve të shkrepur në njerëz. Polemizuan ndërmjet veti se kujt t'i "faturohej" krimi...
Fotografitë e të vrarëve në shtëpi i kishin fotografuar vajzat: Fatbardha Gëxhaliu dhe Selë Gërxhaliu, të dyja të moshës 24 vjeçe. Dhe, filmi ka shërbyer për zbardhjen e vrasjeve në gjykimin e Millosheviqit në Hagë, ku ka dëshmuar Shukriu.
Varrimi i të vrarëve është bërë rreth orës 20. Por, Selatini, Xhemajli dhe Shabani, ishin marrë nga shtëpia para se të vriteshin anëtarët tjerë të familjes dhe ata i kanë vrarë te lumi, ku janë vrarë edhe shumë të tjerë. Varrimi i tyre, edhe pse në rrethana lufte, është bërë në praninë e shumë pjesëmarrësve", thotë Sebahatja.

Safet Krivaça

Kjo është një poezi e rrallë e vitit 1960, nga mjeshtri i fjalës dhe heshtjes, presidenti historik, Ibrahim Rugova.

1.
Me varg në shpirt m`çeli pranvera.
Desha t`jetoj gjithmonë i neshtë.
Më bëhet se do të vajtoj përhera,
Kur po hyj me të madhe në vjeshtë.

2.
Ah, stinë e verdhemtë, stinë e venitur
Vallë, Ty të mallkoi mëma natyrë?
Që bashkë t`shkrihemi kështu t`nemitur,
Mos jemi të mjerë në krijatyrë?

3.
Po ëndërrove me këngë të rritesh,
Dhe ajo jetës përpara t'i flasë.
E di. Me dëng plot do t`goditësh.
E ngado të endesh veç do të vrasë.

4.
Athua Zoti i madh diti të gjykojë
Që njomaket të kalben shi në vrug.
Apo secili barrën e vdekjes të peshojë
N`zjarr të heshtjes i vetmuar si murg?

5.
I ngopur me të vërtetën në gji,
Vëllau im dole n`mesin me erë.
Mbi fytyrën e re t`ra nji vel i zi –
T`nxuer e t`futi n`kuvli përherë.

6.
O kujt t`i falem n`këtë orë t`vështirë,
Kujt t`ia kërkoj hijen e njomësisë?
Pa frikë. Prore do t`jetë djellamirë –
Pikëllimi im, kasnec i gjallë i fuqisë.

7.
Dua të iki fushës e malit-
Jetën e shoh si grusht t`rëndë.
Jo, s`dua të iki. Dua si shpirt djalli
Të ngjitem së bashku në vend.

8.
Bën që për vargjet e mia t`përvëlimit,
Të më quajnë edhe njeri fare t`prishtë.
Po herët i vranë sytë e shtrembërimit,
Se e flas t`vërtetën e kam çiltërisht.

9.
Por nji ditë të dihet se zemra e poetit,
N`dimër a n`verë s`di të ngurrë
Dhe kur e ndjen valën rreth vetit –
Qan e qesh nuk qetësohet kurrë.

HELFER
GENEVE

Sukseset e Helfer
s'kanë mbarim!

www.helferwatches.com

/helfer_lifestyle

Me mjeshtrin e plisave, Sahit Mulën, nga Gjakova

Sahit Mula në punëtorinë e tij

Pse plisi i Gjakovës është më i njohuri në trojet shqiptare?

Punuesit e plisave e ruajnë një thënie: "Plisi është për të mbuluar zinë kombëtare, për një të ardhme më të ndritshme!".

Sahit Mula, në familjen e të cilit trashëgohet historikisht lidhja me patriotët kombëtarë, ndër ta edhe ajo me Bajram Currin, qe një shekull e ka artizanat familjar punimin e plisit.

"Plisi, si simbol kombëtar, është një zanat jo i lehtë", thotë Sahit Mula. Njeriu, i cili e ka udhëhequr ekonominë e shumë ndërmarrjeve në Gjakovë, nga ato të karakterit shtetformues e deri te postet më të larta në ndërmarrjet me renome kosovare dhe sllovene, nuk ka hequr dorë nga punimi i plisit, me qëllim që ta ruajë traditën familjare.

Ai ia ka vë plisin në kokë edhe ish-presidentit Ibrahim Rugova, i cili përcillte punimet e kryesisë së dikurshme të degës së LDK-së në Gjakovë.

Sipas z. Mula, plisi është një kompleks strukturor i veçantë përpunimi. Dhe, si i tillë, nuk është vetëm një "harrën" i bardhë.

Për rëndësinë e plisit, Sahit Mula, në shtëpinë e tij, në vitin 2008, kur edhe e bëmë këtë bisedë, flet si një profesionist që i tregon anët e dobishme të tij, në raport me mbrojtjen e kokës, përveç anës kombëtare që armiqtë kanë pasur frikë prej tij.

SI PUNOHET PLISI?

Sahit Mula përshkruan procesin e punimit të plisit, për të cilin proces thotë:

"Për të punuar një plis, duhet të kalohen 16 hapa, ose procese. E, kjo duhet të përcillet me fuqi punëtore solide. Kjo merr kohë dhe do material kualitativ. Lënda e parë e plisit është leshi i shumëllojshëm.

E kam filluar këtë zanat në vitin 1967, kur babai, Jusufi, u pensionua. E kam trashëguar si art nga të parët, e që tani e tutje e punojmë e tërë familja ime. Me po të njëjtin zanat është marrë edhe gjyshi, Selim Mula, mik, bashkëluftëtar dhe ideolog i Bajram Currit. Pra, familjarisht e kemi punuar këtë zanat në Gjakovë dhe në Shkodër. Ta njohësh traditën e plisit, është

nder. Djali im, Fisniku, që studion për master në Berlin të Gjermanisë, di të punojë plisa.
Pas lufte u mora intensivisht me punimin e plisave, duke e bërë veprimtari të parë profesionale dhe ekonomike familjare".

GJAKOVA ISHTE E LIDHUR ME PLISIN...

Duke folur për ecuritë familjare dhe planet e punës dhe perspektivën, Sahit Mula ka pohuar se në familjen e tij bisedohet shumë për plisin.
"Jemi familje e njohur në Gjakovë dhe për çdo gjë diskutojmë deri vonë pasmesnate.
Kam punuar në shumë funksione ekonomike dhe e kam vënë kokën në rrezik shumë herë, për të mirën e popullit, por kurrë s'kam dashur të fitoj pa djersë. Ende jetoj në shtëpinë që ma ka lënë gjyshi, Selimi.
Gjyshi ka qenë i dënuar tri herë me pushkatim, por fati ishte në anën e tij dhe nuk është ekzekutuar.
Në vitin 1994, presidenti i atëhershëm i Shqipërisë, Sali Berisha, e ka dekoruar gjyshin tim, Selim Mulën, me Dekretin e Presidentit të Shqipërisë, si pjesëmarrës i revolucionit të vitit 1924 në Shqipëri", thotë Sahiti.

CILAT JANË 16 PROCESET E PUNIMIT TË PLISIT?

Për ta punuar një plis, siç u tha më lart, duhen 16 procese, ose operacione pune. 20 orë punë nevojiten për lënurjen e leshit 700 gramë, si lëndë e parë e plisit.
Dhe, duke treguar kurorëzimin e fitimit nga një plis, Sahiti ka shpjeguar se nga një plis i shitur mbesin vetëm 0.25 centë fitim!
"Kur llogaris fitimin, d.m.th., nga katër plisa të shitur, mbetët fitim një euro! Mirëpo, duhet punuar edhe pse fitimi është shumë i vogël.
Bartja e plisit daton qysh moti, por nuk ka një datë apo kohë që thuhet se prej këtij viti apo kësaj kohe...
Ne, si familje, plisin e punojmë qe 106 vjet, llogaritur deri tani. Të mirat e plisit janë të shumta:
E para, e ruan kokën dhe flokun nga dielli, por edhe nga të ftohtit. Por, të gjithë plisat nuk e kryejnë këtë mbrojtje njëjtë. Disa plisa të djersitin.
Sidoqoftë, plisi i Gjakovës është më i njohuri në trojet shqiptare dhe shquhet për mos djersitje të kokës.
Një gjilanas, para disa vjetësh, më tha: "Kam plis, por nuk e bartë, ngase më djersitet koka!".

Presidenti Ibrahim Rugova me plis

I dhashë plisin tim dhe kurrë më nuk ka pasur djersitje. Sepse, plisin të cilin e punoj është i punuar në atë mënyrë që të mbron nga djersitja, meqë e ka një lloj filtri për ajrosje.
Sidoqoftë, pastrimi i leshit luan rolin vendimtar në ajrosje dhe në mbrojtje. Në leshin e përpunuar duhet futur edhe lesh tjetër, që të jetë plisi i butë", thotë mjeshtri Sahit Mula.

Ç'LLOJ PLISASH BARTEN NË TROJET SHQIPTARE?

Në Kosovë, sipas Mulës, barten tre lloj plisash: Plisi i madh, plisi i vogël dhe plisi me maje. Plisi me maje bartet në Rahovec.
Kemi plisa të Lumës, të Korçës dhe plisa të Shqipërisë së Jugut. Në një panair, të organizuar në Gjakovë, kanë qenë të ekspozuar të gjithë llojet e plisave.
Te ne, plisi bartet më së shumti në Anamoravë, në Rogovë të Hasit, në Drenicë dhe në Malishevë.
E, duke treguar për shitjen e plisave, thotë:
"Mesatarisht në ditë shiten rreth 10 plisa. Këtë e dëshmon edhe reduktimi i zanatlinjve, i cili ka rënë nga 22, në 6 sosh, sa edhe jemi tash aktivë.
Shitja e madhe e plisave ka evoluar në kohën e pajtimit të gjaqeve dhe periudha deri në vitin 1998. Ka pasur kërkesa për blerjen e plisit edhe për Ditën e Pavarësisë. Kam bërë edhe një risi në këtë drejtim:
punoj plis me shqiponjë dhe me shkronjat UÇK.
Ka shumë të dhëna që fliten për plisin dhe njëra ndër to është se sa më shumë që është ndaluar bartja e tij, aq më shumë është bartur!
Por, është edhe një e dhënë tjetër për plisin: Plisi i bardhë është për të mbuluar zinë kombëtare!
Prandaj, të flasësh për plisin është histori e gjatë shekullore, të cilën nuk di ta shpjegojë askush, por ka të dhëna që burojnë nga informacione të ndryshme të lashtësisë se plisi bartej edhe nga ilirët", thotë Sahit Mula, i cili këtë zanat e ushtron në shtëpinë e vet.

P. S.
Punuesi i plisave, njëherësh intelektuali i njohur nga Gjakova, Sahit Mula, ka ndërruar jetë në vitin 2017.

Safet Krivaça

Gjithmonë krekosemi. E pse, nuk di!

Ne, shqiptarët, për fat të keq, e kemi adet të krekosemi. Pse? Përgjigjen nuk e di!

Në shitoren afër banesës sime, në Lagjen "Mat" të Prishtinës, blej një birrë gjermane me emrin "Beks", sepse e kam parë në reklamë. Ia jap paratë shitësit, por s'ka dhjetë centë t'mi kthej.
I them: "S'ka gjë, pak punë bëjnë dhjetë centë! Askush s'ka bërë shtëpi me dhjetë centë!".
Shitësi pohon me kokë atë që flisja dhe i vjen mirë. Por, pas meje një i huaj mori një grejpfrut dhe ia jep shitësit që ta peshojë. Kur ia jep paratë, edhe ai pret kusurin.
Shitësi mendon si me shqiptarët, nuk është dert për pak centë. I huaji nuk del jashtë pa ia kthyer centin e fundit... I thotë shitësit: "Kur e fiton vetë, e ruan më mirë. Kur ta jep tjetri, mezi pret ta harxhosh!".
Paj, edhe gjakovarët thonë: "Bëjmë pazar nëse e ke mall të babës!".

ÇKA NUK E FITON VETË, NUK IA DI KIMETIN!

Dhe, teksa nisem të dal nga shitorja, në derë e takoj Nezirin, që sapo kishte ardhur nga Zvicra. Dhe, pa një pa dy, nuk më lëshon pa e pirë nga një makiato.
Hymë në kafeterinë e parë. Dy djem të rinj, rreth 18 vjeç, bisedojnë në telefon me vajzat që janë po aty! Bisedonin sikur njëri të jetë në Amerikë e tjetri në Kosovë!
Ngrihet Neziri, i ofrohet njërit dhe ja ndezë shpullë! Pastaj, i ofrohet tjetrit dhe ja ndezë edhe atij!
"O Nezë, a je çmendur, a?! Më ndale për makiato e po i rrahë njerëzit?! Unë nuk dua probleme, Nezo!", i them.
"Jo, more burrë, i kam djem të vëllezërve! Veç sa ua mbusha telefonat me nga pesë euro mbushje. Ec e mos i mbytë?! Nuk i kam gjetur paratë në baltë!", më thotë ai.
"Heu, Nezë, mirë e ke! Çka nuk e fiton vetë, nuk ia di kimetin", ia kthej.

Safet Krivaça

Gjykatës, të lutem, **më qo në burg!**

Kishte kohë që nuk kisha shkuar në qytezën e vendlindjes. Mos t'ia përmendi emrin se e kanë bërë bozë lypësit...

Shoku im tashmë është bërë gjykatës aty. Ka qenë djalë i mirë në rini dhe, për çudi, i tillë ka mbetur akoma.

E pyeta për punën e tij, e ai më tha: "Më së shumti jam në hall me vullnetarët që kërkojnë të shkojnë në burg!".

U befasova nga kjo që dëgjova...

"Po, kush është çmendur, ore, të kërkojë të shkojë në burg vullnetarisht?!", i them mikut.

Por, teksa bisedojmë, futet në lokal një burrë me vetëm një dhëmb në gojë, rreth të gjashtëdhjetave. Drejtohet për te ne...

"Mirë që të gjeta, zoti gjykatës! Të kërkova edhe në zyrë, por nuk ishe aty. Më kanë zënë me një qerre dru, bre burrë...", foli shpejt e shpejt.

"Po, pse ke marrë dru në mal, bre axhë? A po e sheh se çka të ka ndodhur?", i thotë ai.

"O burrë, pasha Zotin, veç me vdekur nga skamja! S'kam mundësi me e ble një dru për dimër. Kam harruar se qysh duken paratë...

Por, zoti gjykatës, nuk erdha të kërkoj mëshirë e as të ma falësh, por erdha për një gjë tjetër, në paç mundësi ta bësh: Më qo në burg naj ditë dhe ta laj dënimin me burg, se para s'kam! Jam mërzitur në shtëpi, në fukarallëk e skamje... Më qo, bre burrë, tash sa ka nisur dimri se në pranverë kam punë!", i thotë gjykatësit.

Në këto çaste e solla në mendje: Sa e çuditshme është jeta në Kosovë?! Kërkojnë njerëzit vetë të shkojnë në burg, madje edhe nervozohen pse s'i dërgon!

E, ky rast, ma kujton një fjalë të mikut tim në Gjermani. Ai, kur dehej, thoshte: "Pleqëria nuk është për shqiptarë!".

S. Murturi

Sulltanesha shqiptare Safija

Kush ishte vajza nga Dukagjini **që e sundoi botën?**

Kush ishte vajza nga Dukagjini që u bë sulltaneshë, gruaja e Sulltan Muratit III dhe e sundoi botën?

Ka shumë shqiptarë që drejtuan Perandorinë Osmane, që ndërtuan Stambollin. Por, pak shkruhet për rolin e grave në Perandorinë Osmane. Shqiptaret arritën të bëheshin sulltanesha dhe të kishin, kështu, një ndikim të madh në këtë perandori. Historia e Safijes ishte pak përrallore, siç ishte fati i shumë shqiptarëve gjatë kohës së lulëzimit të kësaj perandorie. Ajo u lind në vitin 1550, në zonën malore të Dukagjinit, në fshatin Rez. Safija ishte shqiptare dhe do hynte në histori si sulltane valide.
Burri i saj ishte sulltan Murati III dhe kishte tre fëmijë: sulltan Mehmetin, sulltane Aishen dhe sulltane Fatmën.

SI ARRITI SAFIJA TË BËHET GRUAJA E SULLTAN MURATIT III?

Historia e rënies së saj në duart e sulltanit ishte shumë aventureske. Ajo u kap nga piratët në vitin 1563, në moshën 13-vjeçare dhe u dha si skllave, duke hyrë në haremin e sulltanit.
U bë konkubinë e Muratit dhe në vitin 1566 do të lindë të birin që hyri në histori si Sulltan Mehmeti III.
Safija pat një martesë me sulltan Muratin III për disa vjet. Por, kjo nuk lejohej nga ligjet e kohës. Sulltan Murati III mori edhe dy gra të tjera, të cilat i dhanë 20 djem dhe 27 vajza.
Në këtë periudhë sulltanesha Safije u shqetësua shumë. Ajo e dashuronte sulltanin dhe ishte xheloze për të. Por, më pas e pranoi faktin dhe, me kalimin e kohës, u bë këshilltarja e tij më e besuar.
Aq i madh ishte ndikimi i saj, sa, kur sulltani shkonte nëpër ekspedita, të gjitha çështjet më të rëndësishme të vendit, nga ato politike e ekonomike, ishin të gjitha në duart e saj.

Femrat që e donin Mehmet Kosovën dikur, a do e donin edhe sot?

Mehmet Kosova
në kohën kur shfaqej seriali



Mehmet Kosova tash

Jo moti, konkretisht në vitet 2005-2007, në televizionet tona është dhënë seriali shumë i shikuar turk "Mehmet Kosova", rol të cilin e luante aktori Kenan Imirzalioglu.
Aktori i njohur turk, për të cilin shqiptarët krijuan simpati të madhe (sidomos femrat e adhuronin për bukurinë që kishte), tash, pas 15 vjetësh, duket krejt ndryshe sa i takon look-ut të tij.
Nga një zeshkan seksi dhe shumë i pëlqyer për femrat, aktori turk është shndërruar në një person pa flokë dhe me mjekër të bardhë.
Eh, femra, a do e donit Mehmet Kosovën me pamjen që ka tash?

Anketë me nxënës

Pse nxënësit me zor shkojnë në shkollë?

Shkolla, të pëlqen as s'të pëlqen, është vend ku kryesisht do t'i kalosh 12 vjet të jetës sate, Mund të jenë vjet të mërzitshme ose atraktive, varet shumë nga mënyra që ti zgjedh gjatë kësaj periudhe.

Shkolla kishte reputacion dikur, e tash? Duhet pranuar haptazi se sistemi arsimor tash është i prekur nga probleme serioze: pandemia në njërën anë, në anën tjetër arsimtarët kurrënjëherë nuk janë vlerësuar sa duhet, por janë anashkaluar si shtresë përbuzëse.
Po ashtu, edhe nga ana e nxënësve, interesimi për mësim në këtë kohë pandemie ka rënë dukshëm. Andaj, opinionet e nxënësve të anketuar pasqyrojnë qartë aktualitetin që po mbizotëron sot në shkollat tona...

NUK PO MË MËSOHET, BRE!

Gurseli: - Nuk di, nuk kam vullnet për të mësuar, kur po e di se edhe pas kryerjes së shkollës së mesme do të rri në kateteri, sepse punë s'ka!
Andaj, nuk gjej forcë të kap librin!

PAK NXËNËS NË ORËT E FUNDIT

Anika: - E di dhe jam plotësisht e vetëdijshme se pa arsimim nuk ka të ardhme të shndritshme. Megjithatë, po habitem edhe vetë se si, në këto dy vjet pandemie, ka rënë shumë interesimi për mësim. Dy-tre nxënës në klasën time mësojnë deri diku, e të tjerët, përfshirë edhe mua, të mos flas... Mezi presim të vjen ora e fundit dhe të ikim. Pjesa më e madhe e nxënësve orën e gjashtë e kalojmë në kafiterinë përballë shkollës, sikur e kanë bërë ekskluzivisht për ne...

E DI SE PA SHKOLLË S'KA PUNË. POR, AS ME SHKOLLË S'KA!

Granita: - Shkaku i mosinteresimit të nxënësve për mësim, pa dyshim, është papunësia pas kryerjes së shkollimit. Sidoqoftë, pa shkollë s'ka punë, por as me shkollë s'ka!
Megjithatë, unë nuk shkoj në shkollë sa për të marrë një diplomë. Shkoj në shkollë që të marrë dije, sepse ajo do më shërbej në të ardhmen qoftë në punë, qoftë në krijimin e familjes, e që është domosdoshmëri e një të riu.

SI TË PËRMBYLLET KJO TEMË?

Te ne, në Kosovë, secila parti politike në opozitë rrahë gjoks se me ardhjen e tyre në pushtet gjërat do të ndryshojnë në dobi të hapjes së vendeve të reja të punës. Megjithatë, kur vijnë në pushtet, jo vetëm që i harrojnë premtimet, por mundohen t'i punësojnë të afërmit, aderuesit e partisë së vet.
Ndërkaq, për të tjerët, e që nuk janë të interesuar të kyçen në politikë, punë për meshkuj ka vetëm në ndonjë kafiteri, e për vajza, edhe atë po qe se janë të bukura, në ndonjë butik!

Diturie Haxhaj

Cilët këngëtarë tanë merren me politikë?

Si i dhanë fund martesës Shpëtim Saraçi e Mira Konçi pas 25 vjetësh

Fifi i shkruan letër vetvetes!

Mirlinda Nuhiji - "Linda Lashes"

fiton titullin Grand Master of Lashes

Cilët këngëtarë tanë merren me politikë?

Memli Krasniqi

Eliza Hoxha

Disa nga këngëtarët dhe reperët e skenës në Kosovë e kanë provuar politikën. Madje, disa janë ende në politikë, siç është Memli Krasniqi, tash kryetar i PDK-së, e disa të tjerë e kanë lënë.
Ai që e ka lënë dhe i është kthyer muzikës me një përkushtim edhe më të madh është reperi Genc Prelvukaj. Ai ka punuar gjatë kështilltar politik në Ministrinë e Kulturës dhe në Ministrinë e Bujqësisë.
Sidoqoftë, ende është pjesë e PDK-së, si anëtar i thjeshtë.
Një tjetër këngëtare, e që është deputete në Parlamentin e Kosovës, nga radhët e PDK-së, është Eliza Hoxha dhe është mjaft aktive në politikë.
Para një kohe u fol e u përfol se politikës do ia mësyjë edhe Aida Doçi, por deri më tash nuk e kemi parë të jetë kyçur në ndonjë parti.
"... as që mendoj të merrem ndonjëherë me politikë, sepse unë i përkas artit dhe ashtu do mbetet gjithmonë", pat thënë Aida, në kohën kur përflitej se do t'i hyjë politikës.
Po ashtu, është fol edhe për reperin Ledri Vulën, i cili sikur ka pasur hamendje se a të fillojë edhe me politikë a jo...

Aida Doci

Ledri Vula



Shpëtimi dhe Mira në kohën e rinisë

Si i dhanë fund martesës

Shpëtim Saraçi e Mira Konçi pas 25 vjetësh?

Familja Saraçi në ditët e lumtura

Çifti i njohur në muzikë i viteve 90, Shpëtim Saraçi dhe Mira Konçi, i kanë dhënë fund martesës në mënyrë të pazakontë, 25 vite pasi u bënë të famshëm në publik për romancën e tyre.

Ai, një krijues muzike, dhe ajo ekonomistja që u afirmua si këngëtare me koncertin recital të parë në Shqipëri, ishin ndër të paktat çifte të asaj kohe, që e zbuluan historinë e tyre para kamerave, gjatë një realizimi filmik të transmetuar në ekranin e RTSH-së. Tashmë prindër të dy fëmijëve, Erës dhe Drinit, ata i kanë dhënë fund kësaj historie të gjatë mes artistësh.

Çifti që rreth katër vjet më parë vendosën të shpërnguleshin në SHBA, nuk e kishin menduar se në kontinentin e largët do u ndaheshin edhe rrugët e jetës pas çerek shekulli bashkë.

Por, si duket, kjo shpërngulje për një jetë më të mirë, solli probleme në jetën familjare të çiftit. Shpëtimi dhe Mira i dhanë fund martesës së tyre në SHBA dhe gjatë verës kompozitori u rikthye në Shqipëri, i vetëm.

Mirlinda Nuhiji - "Linda Lashes" fiton titullin Grand Master of Lashes

Të gjithë e njohin "Linda Lashes", sallonin e njohur të Mirlinda Nuhiji, që ndodhet në Zvicër dhe konsiderohet numër një në mbjelljen dhe trajtimin e qerpikëve me metodat më të avancuara.

Mirlinda Nuhiji është profesionistja numër një në Zvicër, në fushën e mbjelljes së qerpikëve. Është kampione e shpallur e këtij profesioni. E certifikuar dhe dëshmuar denjësisht, Linda është histori suksesi në këtë fushë.
"Linda Lashes" ka një nga sallonet më të famshme dhe më të bukura në shtetin zviceran, ku shkojnë kliente të të gjitha nacionaliteteve, për të përfituar nga puna profesionale e Lindës dhe stafit të saj.
Te Linda punohet me teknikën "Russian Volume", e që është mahnitëse. Shërbimi më i veçantë që ofron është qerpiku me ngjyra, por edhe gjatësia maksimale.
Mirlinda, së fundi, ka marrë titullin "Grand Master of Lashes" në Moskë, ku është certifikuar pas trajnimit nga e mirënjohura Natalya Mishnenkova.
Linda mban master class për të gjitha ato që janë të interesuara të kenë një profesion të shkëlqyer dhe fitimprurës.

PRODUKTET E "LINDA LASHES" ME SUPER KUALITET

Siç dihet, "Linda Lashes" ka produkte të personalizuara. Madje, të gjitha produktet me të cilat punon janë të saj dhe të një kualiteti e cilësie superiore.
Sallonet më të njohura punojnë me prodhimet e saj, si dhe i blejnë produktet e "Linda Lashes", të cilat mund të porositen në www.linda-lashes.ch/shop

MIRLINDA NUHIJI JASHTË PROFESIONIT

Linda Nuhiji është bashkëshorte dhe nënë e tri vajzave, e plotësuar tashmë në jetën private dhe atë profesionale dhe është model, shembull pozitiv, për shumë femra që e njohin atë dhe historinë e saj të suksesit.
Njihet si femër e fortë, me vetëbesim dhe plotësisht vetvetja, çka edhe i ka ndihmuar që të jetë kjo që është sot.
Linda është e përkushtuar shumë në synimet e saj për ngritje profesionale, andaj ia ka dalë me sukses.
Si master për mbjelljen dhe punën me qerpik është trajnuar në Zvicër dhe në Moskë.
Bashkëpunon edhe me hotele luksoze të Zvicrës dhe kujdeset për pamjen e klienteles VIP që kanë, e që, sipas marrëveshjes, emrat dhe detajet mbetën diskret.

Nderim Neziri



Fifi i shkruan letër vetvetes!

E dashur Fifi,
Si je?
Uroj të të gjejë mirë kjo letër.
Kam diçka shumë të rëndësishme për të thënë.
A ke menduar, ndonjëherë, të bëhesh njeri pak më i ftohtë?
A ke menduar, ndonjëherë, të mos i marrësh gjërat aq për zemër?
A ke menduar, ndonjëherë, me e kuptuar që jo çdokush do bëhet njësh me atë që ti percepton?
A ke menduar, ndonjëherë, që nuk është e domosdoshme t'u pëlqesh të gjithëve?
A ke menduar, ndonjëherë, ta vlerësosh veten më shumë për atë që je ti, jo për atë çfarë duan të tjerët që ti të jesh?
A ke menduar, ndonjëherë, që jo të gjithë do të të respektojnë?
A ke menduar, ndonjëherë, që duhet t'i struksh mendimet dhe të fillosh mos të përkujdesesh për të tjerët më shumë se për veten?
Jo çdokush do të të kuptoj.
Jo çdokush do ta marrë mendimin për bazë.
Jo çdokush do të të dojë.

CIMA
Construction
KOMPLEKSI
ULPIANA CENTER

CIMA
Construction
Bëhu pjesë e
Kompleksit Cima Tower
+383 49 50 90 90
+383 49 60 10 80
www.cimaks.com

Ana emocionale...

Pse dhe kur qajnë personalitetet, VIP-at?

Jemi mësuar që personazhet e ndryshme publike t'i shohim të hareshëm, të veshur bukur. Por, herë-herë, në intervista të ndryshme, kanë treguar edhe anët e tyre private, emocionale. Dhe, kur nuk kanë arritur të përmbahen emocionalisht, kanë shpërthyer në lot, duke u bërë kështu objekt i diskutimeve të shumta. Ja disa prej tyre...

SALI BERISHËS I DOLËN LOTËT KUR DHA DORËHEQJE!

Kur Sali Berisha dha dorëheqje nga të gjitha postet e tij drejtuese në Partinë Demokratike, shkaku i humbjeve në zgjedhjet vendore të vitit 2013, askush nuk u besonte syve edhe veshëve në ato momente.

Por, ajo që i la të gjithë gojëhapur ishte momenti kur Berisha u mallëngjye gjatë fjalimit dhe nuk i përmbajti lotët, të cilët nisi t'i fshinte me shami, duke shkaktuar jo pak dhimbje për simpatizantët e tij.

LORIK CANA QANË KUR I KUJTOHET LUFTA NË KOSOVË

Futbollisti Lorik Cana, jo pak herë ka treguar se është njeri me zemër të madhe dhe shumë i ndjeshëm.

Por, askujt nuk ia priste mendja se ai do përlotej, siç i ka ndodhur në një studio televizive.

Ai ka shpërthyer në lot sapo ka nisur ta kujtojë luftën në Kosovë, si dhe shokun e tij, Kushtrim Kelmendin, të cilin e kishte humbur në luftë.

BEATRIX RAMOSAJ QANË NË SPEKTAKËL

Këngëtarja Beatrix Ramosaj ka treguar se është artiste me shpirt melankolik. Dhe, si e tillë, lotët i rrëshqasin lehtë nëpër faqe, sa herë që ndihet e emocionuar.

Por, ajo që nuk mund të harrohet aq kollaj është e qara e saj në spektaklin "Your Face Sounds Familiar".

Këngëtarja ka shpërthyer në lot edhe kur ka qenë pjesë e Spektaklit "Big Brother", meqë i mungonin familjarët.

Mjerë shtëpia që e ka...

Kush është shqiptari që veten e quan Drazha Mihajlloviq?

Lulzim Ademi, i kërkuar për krime e i arratisur në Serbi, dëshiron ta quajnë Lul Drazha. Pse?
Lulzim Ademi, nga Broboniqi i Mitrovicës, një ishpolic i Serbisë gjatë okupimit serb, ka rrëfyer me krenari se e njeh shtetin e Serbisë dhe kurrë nuk e pranon Kosovën si shtet. Por, ajo që është edhe më skandaloze, ai është vetëpagëzuar me emrin Drazha Mihajlloviq dhe se e ndien veten serb.
"Lulzim Ademi, pos para luftës edhe gjatë saj, ka qenë bashkëpunëtorë me policinë serbe. Më 20 maj të vitit 1999 u ka pri forcave ushtarake, policore, paraushtarake dhe civilëve serbë të armatosur kur janë djegur fshatrat Koprivë dhe Broboniq. Atë ditë janë djegur gjithsej 141 shtëpi dhe janë vrarë gjashtë shqiptarë", thotë Halit Berani, aktivist i të drejtave të njeriut.
Lulzim Ademi ishte dënuar në Kosovë me 20 vjet burg për krime lufte ndaj bashkëkombasëve të tij, por kishte arritur të arratisej nga burgu në vitin 2000. Ai vazhdon të kërkohet për të vuajtur dënimin.
Lul Drazha, me një pjesë të familjes, jeton në Novi Sad.

Si e mashtroi një djalë hoxhën?

Dimrit Met, verës Muhamet!

Ishte bërë një dasmë në një fshat në dimër. Dhe, meqë nuk kishin hoxhë në fshat, e çojnë një djalë të ri për ta marrë hoxhën në fshatin tjetër. Kishte rënë borë e madhe dhe duhej të çahej bora, për t'u hapur rraha. Kur u nisën, Hoxha i tha djalit:
– Prij ti përpara, djalë i mirë!
– Jo, nuk ban unë me ecë para, se asht marre me ecë para hoxhës!
Hoxha nja një orë udhë priu, duke e çelur rrahën. Kur mbërritën në fshat, një burrë, pasi e përshëndeti, i tha hoxhës:
– A mun erdhe hoxhë? A u lodhe?
Pastaj, e pyeti djalin:
– Muhamet, a pat shumë borë rrugës?
Atëherë, hoxha iu kthye djalit e i tha:
– Allahile, a Muhamet e ki emnin, a?! Eu, ta kisha ditë që e ki emnin Muhamet, tybe treqin tybe nuk kisha ecë para teje, se nuk ecet para Muhametit! Po, unë kur të veta, ti m'the se e ki emnin Met!
– Dimnit e kam Met, kurse verës Muhamet! - ia ktheu djali.

Tri kosovaret e suksesshme...

Dikur refugjate, *tash gra të fuqishme*

Këngëtarja botërore, Dua Lipa, regjisorja Blerta Basholli dhe aktorja shumë e suksesshme Yllka Gashi, po shënojnë suksesin e filmit artistik të metrazhit të gjatë "Zgjoi", që po shfaqet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Filmi "Zgjoi" po i shpërfaqë botës vuajtjet e popullit të Kosovës, të cilët përjetuan tmerrin nga ushtria dhe paramilitarët serbë, e si pasojë, përpos vrasjeve të shumta, përdhunimeve dhe mijëra të zhdukur, një përqindje e lartë e popullsisë ishte detyruar të lëshojë vendin, duke kërkuar strehim në të katër anët e botës.

Pikërisht, Dua Lipa, Blerta Basholli dhe Yllka Gashi,
kanë përjetuar në lëkurën e tyre ndjesinë e refugjatit. Përpos Dua Lipës, e cila prindërit i kishte emigrantë në Angli, por që këtë histori e ka shumë të afërt nga rrëfimet e prindërve të saj, dy të tjerat e kanë përjetuar në veten e parë.

Yllka Gashi gjatë luftës ishte në Maqedoni, kurse Blerta Basholli në Gjermani.

Rohs'a Linda

/lindakoshiofficial



24 anëtarë familjeje kundër një nuse 13 vjeçe dhe atë të rrëmbyer në rrugë, 22 vjet më e re se burri...

Si u bëra nuse 13 vjeçe?

Kam vuajtur shumë. Në vend se të luaja me lodra, u bëra nuse në moshën 13-vjeçare. Mundohem shpesh që dhunën e dikurshme ta kthej në argëtim, por është dashur të kalojnë 34 vjet jete të zezë.

Kam qëndruar e mbyllur në shtëpi 5 vjet, madje edhe 17 të tjera në kurbet. Nuk më la të dal nga muret e banesës dhe u desh të plaket e amortizohet, që unë ta shoh vendlindjen time pas 14 vjetësh.

ÇKA DIJA UNË PËR PUNË INTIME?

Kam qenë një vajzë më e zhvilluar se fëmijët tjerë. Por, isha vetëm 13 vjeçe, kur ai, pra burri im i tashëm, më ndaloi në rrugë dhe më luti të hipja në

kamionin e tij.
Ishte 22 vjet më i vjetër se unë dhe punonte punë të ndryshme në ish-Jugosllavi. Ai i përkiste një familjeje të fortë nga meshkujt dhe kishte para, e unë kisha vetëm babanë dhe motrat më të vogla.
Më tha se herën tjetër do më marrë në kamion pa më pyetur fare. Sidoqoftë, nuk u frikësova dhe as nuk e mora të madhe...
Në ditën tjetër, derisa po kthehesha nga shkolla, ai zbriti nga kamioni dhe më futi në të. Më dërgoi te një shtëpi e braktisur. Çka dija unë për punë intime? Nuk dija të flisja asgjë gjatë aktit! Ishte e tmerrshme kërkesa e tij që të flisja gjatë aktit!
Dhe, pas disa ditësh në atë shtëpi, erdhi babai i tij, e që mendova se do e qortonte dhe do më lironte. Por, doli e kundërta! Babai i tij, më tha: "Do të japësh deklaratë në polici dhe do të thuash e ke dashur vetë këtë njeri dhe nuk do të ndahesh kurrë prej tij! Ndryshe, nuk do të ekzistosh as ti e as familja jote!".
E, atij as që i interesonte gjendja ime shëndetësore dhe psikike, e aq më pak i bënin përshtypje lotët e mi dhe kërkesat të më qonte në shtëpi...

PRANOVA SE E MORA VETË DHUNUESIN!

Duke më gënjyer se do më lironte prej tij, posa të deklarohesha zyrtarisht, ai bëri kërkesat detyruese që të flisja siç i konvenonte atij, në mënyrë që të lihesha e lirë...
Ata kishin plane, por unë isha ende fëmijë që t'i kuptoja intrigat. Në emër të shpresës se do më lironte, unë i premtova atij se do të deklarohesha si do ai vetë.
Por, edhe policët ishin në krahun e tij...
Dhe, pas disa pyetjesh, njëri nga policët doli aty ku e donte interesi i burrit dhe familjes së tij, duke e mbyllur deklaratën me përfundimin se gjërat ishin zhvilluar me pëlqimin tonë të plotë!
E, posa erdha në shtëpi, më veshën me vello, më lyen e ngjyen...
Dhe, kur më ofruan te pasqyra që ishte varur në mur dhe e pash veten në të, shikova mos ishte pranë meje dikush tjetër! Pastaj, filluan këngët, ahengu, nisi dasma... Nuk më jepej rasti të thosha se kjo punë s'kishte lidhje me martesë të dëshiruar dhe as që kisha ëndërruar të bëhesha nuse, derisa çanta e shkollës më kishte mbetur në dollapin e shtëpisë së vjetër në fshat.

SI MË QORTOI MJEKU NË SPITAL?

Një javë pas ditës së nusërisë, një mbrëmjeje para se të darkonim, mu errën sytë dhe më lëshuan këmbët. Ishte hera e parë që alivanosesha.
Dhe, në ato çaste, më hipën në veturë dhe më dërguan te mjeku. Ai, pas një kontrolli të shkurtër, dha propozimin urgjent për në repartin gjinekologjik, si një femër e re me trauma psiko-fizike nga aktet e marrëdhënieve intime.
Gjinekologu, pasi më kontrolli, më tha: "Cila kafshë ka bërë kështu me ty?".
Mjekët e qortuan burrin dhe familjen e tij, sa nuk donin t'i shihnin brenda, ndërsa për mua thoshin se ende nuk kishin parë se ndokush ishte bërë nuse në moshën 13 vjeçe...
Sidoqoftë, disa ditë qëndrova në spital dhe më dhanë disa doza gjaku.
E, pasi më nxorën nga spitali, më vunë në sprovë të re, duke më detyruar t'ua pastroja këmbët të gjithëve!
Më trajtonin keq edhe në ushqim, sepse bukë haja e fundit!

UNË, NUSJA 13 VJEÇE, FAJTORE PËR ÇDO GJË!

Unë, nusja 13 vjeçe, jo vetëm se shkatërrohesha shpirtërisht dhe fizikisht çdo ditë e më shumë, por edhe isha fajtore për çdo gjë që ndodhte në atë shtëpi të mallkuar...
Ata kishin mjeshtri t'i intrigonin gjërat deri në masën sa nëpër fqinjësi kishin thënë se kjo vajzë, 13-vjeçare, e ka mashtruar burrin 22 vjet më të vjetër se vet!

PSE VENDOSA TË BËHEM KURBAN I FËMIJËVE?

Dhe, sa herë që më kujtohen detajet e asaj kohe, ende kërcej në gjumë! Ndodh edhe bërtas natën! Fëmija, e që tash janë rritur, më pyesin shpesh pse tremben natën...
Kur kam momente lumturie që lidhet me fëmijët e mi, më kujtohet dhunimi i tij dhe lumturia më zbehet aty për aty...
O Zot, i them vetes, sa keq kur jeton me njeriun që të ka dhunuar?! Sa keq kur jeton me dikë që s'e do, e duke qenë kurban i fëmijëve?!

V. I.

Si u bëra dashnore dhe grua e shefit tim!

Para pesë vjetësh nisa të punoj në një butik të qytetit tonë. Mezi u punësova, meqë në konkurs u paraqiten shumë vajza, madje edhe më të bukura se unë.

Konkurrova për të provuar fatin dhe "shkrepi", siç thonë në qytetin tonë. Thënë të drejtën, në bisedën që pata me shefin kur konkurrova, ai nuk më pyeti edhe aq shumë se kush jam, e kujt jam...

E, si të ngjalleshim pak materialisht, kjo ishte primare për mua, sepse jetonim me pensionin e babait, kurse nëna ende nuk kishte arritur të pensionohej.

Dhe, erdhi dita ku nisa punën. U gëzua im at, u gëzua ime ëmë, por, kuptohet, më shumë u gëzova unë.

E, kur e mora rrogën e parë, gjysmën e parave ia dorëzova babait, e me gjysmën tjetër bleva fustan të ri, bluzë dhe këpucë të reja.

Në muajin tjetër filluam të krijojmë pak standard. E, në muajin e tretë gjendja pak ndryshoi. Ato ditë kishim pak më shumë punë se zakonisht. Pas orarit të punës nuk shkonim në shtëpi si zakonisht, por prisnim mallin e ri. Madje, një të shtunë u vonuam aq shumë duke vendosur në rafte mallin e ri, sa gati u bë gjysma e natës.

PA FIJE TURPI MË THA: "DËSHIRON TA KALOSH ME MUA NATËN NË HOTEL?"

"Dëshiron ta kalosh me mua natën në hotel?", më tha shefi im.

U befasova. Më erdhi kjo si prej qiellit. Kur u ktheva në shtëpi i tregova nënës. Por, për çudi, ajo e mori si për shaka...

Të njëjtën pyetje shefi im ma bëri edhe ditën tjetër. E, kjo më detyroi t'i them se jam e re (ani pse isha 22 vjeçe), se kam dashnor, me të cilin mendoj të martohem.

E ai, pasi më buzëqeshi, më tha: "Nuk të bie keq po e pranove propozimin tim! Do ta kesh edhe rrogën më të madhe".

Kategorikisht e refuzova dhe i thashë të mos bisedojmë më për këtë gjë. Kur i tregova nënës se kategorikisht e kisha refuzuar, më tha:

"Mendohu për këtë! Ç'të gjen?! Ti thua se ke dashnor, por unë e di saktësisht se ti nuk ke të dashur. Po të donte ai, unë do të shkoja në vendin tënd, por ai mua nuk më do", më tha, duke ma tërhequr vërejtjen të mendoja seriozisht për këtë punë.

Ditët që pasuan ishin të vështira për mua. Shefi filloi t'më qortonte se së shpejti, ndoshta, do të mbetem edhe pa vend pune, sepse kinse kishte shumë punëtore dhe duhej ta largonte një nga puna...

Kjo më nevrikosi shumë. Mbeta në udhëkryq: t'i dorëzohem shefit tim, apo të bredhë si dikur rrugëve e papunë...

SI VENDOSA TË BËHEM DASHNORE E SHEFIT TIM, QË TË MOS E HUMBJA VENDIN E PUNËS?

Dhe, ndodhi ajo që nuk duhej të ndodhte: vendosa të bëhem dashnore e shefit tim, kryesisht që të mos e humbja vendin e punës...

Por, deshi Zoti e shefi im gradualisht filloi të dashurohej në mua dhe, të dielave, kur e kishim pushim, vazhdimisht më thërriste në telefon. Kjo gjë më gëzonte, sepse e shihja se ai më donte dhe nuk e kishte pasur qëllimin të më largonte nga puna...

Tash, 4-vjetorin e martesës sonë, që e patëm para pak ditësh, e festuam me dy vajzat tona të bukura, si drita...

E.

ALAYAH

LUXURY STYLE

alayahluxury

"A është i lirë vendi?", më tha një zë i befasishëm, se pranë meje ishte një ulëse e lirë në autobusin e asaj pasdite që vinte nga Gjakova për në Prishtinë.

Nga autobusi dhe drejt e në shtrat!

U largova pak anash, në drejtim të dritares, duke i liruar vendin e lirë një djaloshi, me një torbë të vogël në krah.
Pasi u ul, nxori nga xhepi i xhaketës telefonin dhe nisi ta hapë, pa pasur fare vëmendjen te bashkudhëtarja që ia mundësoi të ulej pranë saj.
Herë-herë mundohesha ta shikoja me bisht të syrit, megjithëse kisha dëshirë të paraqitesha indiferent si ai ndaj meje...
Pas pak konduktori erdhi për biletë dhe secili prej nesh pagoi për vete.
Më bënte përshtypje se çka shikonte në telefon dhe unë, herë-herë, me bisht të syrit, mundohesha të shikoja se çka shikonte...
Pas pak pash se kishte hapur faqen e horoskopit. Kjo më dha mundësi ta pyesja: "Më fal, a ka mundësi t'më tregosh se çka po shkruan për shifrën "Demi", sepse unë jam Dem në horoskop".
Dhe, që nga ai moment filloi biseda jonë e rastësishme, por e këndshme...
Më tha: "Po më dukesh fytyrë e njohur?".
Unë, në vend të përgjigjes vetëm rrudha krahët, ndërkaq pas pak i thashë: "A je nga Gjakova edhe ti?".
"Unë jam nga Prishtina, por isha te një hallë imja në Gjakovë", ma ktheu.

KUR ARRITËM NË PRISHTINË ISHA NË GJENDJE TË BËJA ÇKA T'MË THOSHTE!

Pasi filluam të bisedonin pak nga pak, e ndjeja veten të lumtur që isha me një tip si ai, të paktën ashtu më dukej mua.
Gjatë rrugës i thashë se jam studente dhe banoja në konviktin e studentëve.
Diku kah "Guri i Zi" filluam të bisedonim edhe për dashuri...
Dhe, kur arritëm në stacion të autobusëve në Prishtinë, dolëm nga autobusi, u nisëm bashkë për në qytet dhe, kur arritëm te "Santeja", më tha të uleshim diku e të pinim nga një kafe.
Dhe, unë, pa u hamendur fare, pranova...
Zihesha në vetvete, sepse ishte hera e parë që përjetoja diçka të veçantë, si asnjëherë më parë.
Kur u ulëm në kafiteri, kur erdhi kamerieri, ai tha:
"Dy makiato të mëdha!".
"E, ku e di ti se unë dua makiato?!", ia ktheva me një qeshje të lehtë.
"E di, sepse të ftova për një kafe e jo për një pije", më tha.
Kur i pimë kafetë, më tha:
"Kam një propozim: të shkojmë në banesën time në Ulpianë, ta lë torbën dhe dalim diku për darkë".
Në këtë çast u ndodha para një udhëkryqi: Kah t'ia mbaja? Ta humbja një mashkull të tillë?!
Andaj, mbylla sytë dhe vendosa të shkoj me të dhe le të dalë ku të dalë...
U ngritëm dhe dolëm nga kafiteria. U nisëm kah thoshte ai. Duke u dridhur thashë me vete: nganjëherë duhet rrezikuar për të gjetur fatin e jetës...
Kur arritëm në banesën e tij, nxori nga xhepi çelësin dhe nisi ta hapë derën.
Në çast, i thashë:
"Pse nuk i bie ziles që ta hapin derën?".
"S'ka kush ma hap, sepse familjen e kam në Australi! Jetoj i vetëm në banesë".
Kur e hapi derën, më tha: "Je e mirëseardhur! Urdhëro brenda!".
Shtanga. Të hyja a të mos hyja?
Dhe, vendosa të hyja...
U ula në kanape. Ai kaloi në kuzhinë. Dhe, kur u kthye, kishte në duar shishen e kokakollës dhe dy gota.

NË SHTRAT ME BASHKUDHËTARIN!

Dhe, pa më thënë asnjë fjalë tjetër veç atyre: "Të lutem, mbylli sytë", shijova buzët e tij, të cilat u puthitën me të mijat dhe duart e tij gjithnjë e më shumë depërtonin nëpër trupin tim...
Në fillim nisa paksa të reagoj, por ai nuk u ndal dhe çdo gjë përfundoi në shtratin e tij të fjetjes, e ndezur e bërë flakë në trup...
Të nesërmen, herët në mëngjes, dikush i ra ziles. Ai doli të shikonte se kush ishte dhe u vonua pak...
Kur u kthye, tha: "Dikush pa lidhje pyeti për një person që nuk e njihja!".
Por, vërejta se ai sa vinte e skuqej në fytyrë. Andaj, kuptova se ishte dikush me rëndësi, e jo sa për sy e faqe.
I thashë troç: Kush ishte?
Më tha: E fejuara ime. I thashë të mos hynte se kisha një shok në shtëpi".
Dhe, pa e zgjatur fare, mora valixhen dhe dola, ani pse ai nisi të arsyetohej...
Teksa dola nga banesa, vetes i thashë: "Eh, Lumnije, sa mendjelehtë u tregove!".

Lumnije L.

DENTFIX

ORDINANCA STOMATOLOGJIKE

Realiteti i ditëve tona...

Më shumë *dashurojmë a tradhtojmë?*

Sinqeriteti në dashuri është më i rrallë se uji në shkretëtirë. Andaj, shtrohet pyetja: Më shumë dashurojmë a tradhtojmë?

LULE OSMANI, 29 VJEÇE, NGA PRISHTINA: ÇDO LIDHJE FILLON JO SERIOZISHT!

"Kudo shohim të rinj dorë për dore, madje edhe njerëz të pjekur. Por, kurrënjëherë nuk flitet se a dashurohen ata, vërtet, a po sa për sy e faqe... Mendoj se çdo lidhje e re ndërmjet dy të rinjve, apo edhe të atyre më të pjekur, fillon jo seriozisht. Por, as femra e as mashkulli nuk ia bëjnë me dije partnerit një gjë të tillë.

Sepse, çdo mashkull, për ta shti në dorë një femër të bukur është në gjendje të bëjë çdo gjë: ta zbukurojë biografinë e tij jetësore, ta paraqes veten Don Zhuan, e të tjera të ngjashme. Por, me kalimin e kohës, ajo lidhje, nëse nuk bëhet serioze, përfundon me ndarje".

ALINA SEJDIU, 22 VJEÇE, NGA FERIZAJ: ÇDO FILLIM ËSHTË I ZORSHËM!

"Fillimi i çdo dashurie është i zorshëm. Andaj, edhe pse kam pasur fatin të njoh dhe dalë me disa meshkuj, me asnjërin s'kam arritur të krijoj një lidhje të sinqertë, serioze!

Njëri më thoshte se kishte këtë e kishte atë... Ndërkaq, s'kishte gjë pas shpirtit. E vërteta ishte se ai mezi kishte arritur të marrë diplomën e shkollës së mesme për zdrukthëtar!

Andaj, unë nuk mund të jem me një tip i cili nuk flet seriozisht. Nuk di pse ka nevojë të më gënjej mua?!

E, nëse krijoj lidhje me një të tillë, i cili çdo të dytën fjalë më gënjen, si do jetoja me të tërë jetën?!

Andaj, më mirë po rri kështu si jam e vetëm, sesa në lidhje e me gënjeshtra...

E, deri kur kështu, një Zot e di?!

ERBLIN VRANISHTI, 31 VJEÇ, NGA PRIZRENI: SINQERISHT DASHUROJNË VETËM POETËT!

"Kam lexuar Zef Serembën, Hilë Mosin, por edhe shumë romane të autorëve të huaj. Andaj, edhe kam vërejtur se sinqerisht dashurojnë vetëm poetët, shkrimtarët! Sipas tyre, dashuria është dashuri deri në amshim...

Por, unë kam mendim të kundërt: Sot një lidhje dashurie nuk mund të funksionojë pa dredhi e trillime, sepse koha është për gjëra të tilla...

D. H.

Mos ia jepni patentë-shoferin gruas sime!

Puna e patentë-shoferëve është bërë si " boza e Haxhi Agës", thonë në vendlindjen time.
Na e porositi kolegia nga një pije, në shenjë të qerasjes për marrjen e patentë-shoferit.
Dhe, m'u kujtua gruaja ime, kur hyri në provim për patentë-shofer.
E shikoja me kureshtje se a dinte ta drejtonte veturën e vogël "Opel Corsa" të Ministrisë së Tregtisë e Transportit.
Kur u nis, m'u duk se u nis me shpejtësinë e katërt! Ecte si anija kur tundet në valët e detit! Me t'u kthyer, ia zgjatën dorën e i thanë: "Urime, ke kaluar!".
U ofrova, u thashë: "Për hir të Zotit, mos e kaloni se e pash që nuk ishte askund!".
"Kështu e dashke gruan ti, a?!".
"E dua shumë. Por, nëse ia jepni patentë-shoferin, ajo do e thyejë kokën diku!".

Nëse nuk pi raki, nuk je poet!

Dikur janë shitur shumë librat me poezi. Kanë qenë vitet shtatëdhjetë e tetëdhjetë, kohë revolucioni në leximin e kësaj literature në Kosovë, bashkë me këngët patriotike.
Në koncerte ua kemi vënë flakën sallave...
Kemi duartrokitur për secilin poet, qoftë ai edhe palaço, kur ka lexuar ndonjë varg patriotik!
Ndërkaq, në orët e dikurshme letrare, shtrohej edhe darkë, raki...
Aso kohe mendonim se poet i madh është vetëm ai që pi shumë raki dhe jeton i dehur gjatë gjithë jetës, sepse kishim dëgjuar se rakia e reduktonte vuajtjen shpirtërore...
E, kjo mendësi jeton akoma te poetët e rinj, që kanë bërë hapat e parë në thurjen e vargjeve poetike...
Një i tillë u fliste dy vajzave të reja, që sapo kishin nisur me shkrime.
Ato e dëgjonin me vëmendje. Më pas, njëra i thotë tjetrës:
"Unë s'paskam si të bëhem poete, andaj po e lë këtë punë që tash!".
Unë nuk qëndrova indiferent ndaj fjalëve që i dëgjova dhe u thashë:
"Vajza, për t'u bërë poet sot është shumë lehtë. Poetët janë, zakonisht, njerëz të dështuar në jetë. Prandaj, si të tillë, i turrën rakisë, duke qëndruar në lokale derisa t'i përzë kamerieri!
Andaj, nëse doni edhe ju t'u përzë kamerieri nga lokali, bëhuni poete!".

S. Murturi

MAGJISTARJA

lindjavdekja@hotmail. com

Për hapje të fatit, për strese, sëmundje depresive, për forcim të bashkëshortësisë, për largim të magjive, për ecje të mbarë të biznesit, për rritje të vetëbesimit dhe për sugjerime e ndihmë me barëra popullore, por edhe për gjithçka për jetë të lumtur

kontaktoni në këtë email adresë:

lindjavdekja@hotmail. com

A është reale pamja që më shfaqet natën?

Jam grua, 78-vjeçare, jetoj në një fshat të Pejës. Kemi një terrinë afër shtëpisë dhe, pikërisht, dritaret e shtëpisë sime janë kah ajo. Ka dy muaj që, sa herë hapi dritaren natën, shoh se kah terrina lëviz diçka dhe pastaj bëhet sikur ec si hije. Kjo ndodh pothuajse çdo natë...

Por, qe një javë hija nuk shihet më...

A është ajo hije reale apo hije që më bëjnë sytë?

"E dyshuara"

Përgjigje:

Ju keni një moshë, e cila mund t'u qojë në pamje surreale. Shtëpia juaj mund të jetë ekspozuar nga reflektimet e farëve të veturave dhe automjeteve të tjerë, të cilët mund të reflektojnë hije kur ato ndeshen.

Terrina që ju e keni përmendur është me kaçuba dhe aty ka gjarpërinj e gjallesa të tjera, por që nuk janë për t'u frikësuar.

Andaj, nuk shoh se ka diç të çuditshme, por një normalitet zhvillimor, e që ju, krahas moshës dhe legjendave me të cilat jeni rritur, keni një paragjykim të caktuar mistik dhe ky misticizëm e jep një pamje çfarë keni theksuar.

A të ndahemi?

Jam M., 38-vjeçare, jetoj jashtë të Kosovës. Kam probleme me burrë, të cilat kanë vazhduar vit pas viti.

Para 7 vjetësh, me terapinë tënde, gjendja u qetësua mirë, por ndodhi ashtu sikur më ke thënë se ky pas 6 a 7 vjetësh përsëri do të bëjë probleme, duke gjetur femër tjetër, e cila do u sjellë në pragun e ndarjes.

Dua të di, zonjë e nderuar, a do të ndahemi apo do të jetojmë bashkë?

"E lodhura"

Përgjigje:

Besoj se do ta vazhdoni jetën së bashku. Femra që e ka gjetur burri yt, për fat të mirë, nuk është e familjes së keqe, por ky nuk ia ka treguar të vërtetat nga jeta e vet familjare dhe ajo ka rënë viktimë e mashtrimit. Prandaj, tani që kanë ardhur gjërat deri këtu, ajo do të tërhiqet, posa t'i kuptojë disa gjëra që nuk i ka ditur. Ju mos u tensiononi, sepse për ty përsëri do të ketë diell...

Jetoj me dhimbjet e përditshme...

Jam nënë, i kam dy fëmijë: 22 dhe 20 vjeç, jetoj jashtë Kosovës. Jetoj me një shqetësim të përditshëm, duke pasur dhembje çdo ditë diku.

E, kur shkoj tek mjeku, nuk del se kam probleme.

I kam bërë analizat sa e sa herë dhe çdo gjë e kam mirë. Megjithatë, nuk ndjehem mirë...

Djemtë i kam në rrugë të mirë, nuk konsumojnë as duhan e as alkool.

Pse e kam këtë problem, motër e nderuar?

"Largësia"

Përgjigje:
Ti, në fakt, nuk e ke këtë problem prej sot, por kështu ke jetuar që nga fëmijëria. De fakto, nuk je paciente, por nuk je edhe larg pacientes. Nuk ke asnjë problem, por ke dhimbje që shkaktohen nga baza nervore, e që rrjedhë nga e kaluara traumatike.
Traumatizmi nuk shërohet lehtë. Brezat tanë jetojnë me trauma dhe kanë nevojë për shërim. Dhe, shkaku i traumave në botë ka shumë vrasës serikë, që kanë kryer krime edhe nëpër spitale të reputacionit botëror, e lëre më rrugëve...
Në rastin tënd, nuk bën punë mjekësia, e as jeta klinike, sepse kur je mirë me analizat mjeko-laboratorike, barërat përjashtohen si zgjidhje.
Lufta të mbetët ty, prandaj edhe ka shërim alternativ...

A do të ketë vëllai fëmijë?
E nderuara zonjë, jemi tri motra dhe dy vëllezër. Ajo që po na brengosë më së shumti është se vëllai i madh është martuar qe 15 vjet, por nuk ka ende fëmijë.
A do të ketë fëmijë?

"Selja"

Përgjigje:
Këtu nuk mjafton të thuhet ka me pasur apo nuk ka me pasur fëmijë, sepse mosha e bënë të veten...
Para së gjithash, duhet ta kenë kryer testin spermografik dhe të jepet diagnoza. Sepse, derisa nuk ka diagnozë të vërtetuar, ky problem konsiderohet i shkaktuar nga steriliteti.
Duhet ta kenë saktë diagnozën dhe konform diagnozës të bëhet zgjidhja e problemit.
Nëse e keni diagnozën, ma dërgoni me një letër tjetër. E, nëse çifti ka qenë në trajtim dhe mjekësia nuk ka gjetur defekte e as probleme, kam mundësi ta marr për trajtim.
Andaj, drejtohuni te unë me një letër tjetër, qoftë në internet në adresën time lindjavdekja@hotmail.com dhe më shkruani që të di njërën prej këtyre arsyeve.

E doja, por nuk e dua më burrin!
Jam e martuar, kam një fëmijë, por kam një problem që po më brengos shumë. Nuk jam kah mundem ta shoh me sy burrin tim!
Kur po del nga shtëpia po gëzohem, po ndihem mirë.

PËR LEXUESIT E DIASPORËS
Pyetjet tuaja dërgoni me postë në adresën: "Kosovarja", fahu postal 18, 10 000, Prishtinë, Kosovë.

Nuk ka qenë kjo gjendje nga fillimi, e as nuk kam ndonjë hile, nuk e tradhtoj, por ja që më është fiksuar në kokë dhe nuk jam kah mundem ta dua.
Po dyshoj se kemi magji, sepse nuk është asgjë në shtëpi siç ka qenë përpara...
Të lutem, më ndihmo që të jem si dikur, ta dua burrin dhe të mund të qëndrojë pranë tij...

"D."

Përgjigje:
Keni magji. Keni në shtëpi disa letra të mbështjella që nuk janë kuranore, përkundrazi janë me disa shenja që nuk i kupton askush dhe them se gjërat e dyshimta nuk duhet të jenë pjesë e shtëpisë.
Ato i keni në sallonin e shtëpisë, konkretisht te sirtari i detergjenteve. Gjeni, mos i hapni, por largoni nga shtëpia!
Kjo magji u është bërë për t'ua shkatërruar martesën, sepse dikë, në rrethin familjar, e pengon lumturia juaj familjare.

/mollamarkt_eferding

Tel: +43 676 4817639

SHERWOOD
Resorts and Hotels

Feel the Legend

SHERWOOD EXCLUSIVE KEMER
KEMER / ANTALYA

SHERWOOD EXCLUSIVE LARA
LARA / ANTALYA

SHERWOOD DREAMS RESORT
BELEK / ANTALYA

TUI BLUE BELEK
BELEK / ANTALYA

SHERWOOD SUITES RESORT
LARA / ANTALYA

SHERWOOD GREENWOOD RESORT
KEMER / ANTALYA

SHERWOOD PRIZE HOTEL
LARA / ANTALYA

+90 242 444 88 07
www.sherwoodhotels.com.tr